




Tirana International Airport
Nënë Tereza



EKSTRAKT NGA
RAPORTI
VJETOR I TIA-s
2008

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport
Nënë Tereza
Administration Building, Rinas
Tirana, Albania
Phone: +355 4 2381 600
Fax: +355 4 2381 545
E-Mail: info@tirana-airport.com
Web site: www.tirana-airport.com



Date: 09.04.2009

Personi përgjegjës: Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive

Tirana International Airport SHPK

Tirana International Airport Nënë Tereza

Rinas, Tirana


Albania

Tel: 00355 4 2381 600

Fax: 00355 4 2381 545

E-Mail: info@tirana-airport.com

www.tirana-airport.com



Një përmbledhje për 2008

- Më 15 mars 2008 një depo municionesh shpërtheu në fshatin e Gërdecit, 7km larg nga aeroporti. Një eksplozion i tillë shkaktoi 26 të vrarë dhe shumë të plagosur. Pas kësaj ngjarjeje, aeroporti u shndërrua në pikë kyçe për shumë fluturime humanitare nëpërmjet të cilave u ofrua ndihma e shpejtë për të plagosurit dhe transportimi i personave në gjendje të rënde në spitalet jashtë vendit.
- Më 28 mars 2008 TIA firmosi marrëveshjen financiare për zgjerimin e aeroportit duke rritur fondet e investimeve të aeroportit me 22 milionë EUR. Firmosja ndodhi gjatë një ceremonie me financuesit dhe Organe të autorizuar shtetërorë, të përfaqësuar nga Ministri Sokol Olldashi dhe Ministri Genc Ruli.
- Më 25 korrik 2008 TIA nisi punimet për ndërtimin e Fazës B, me një ceremoni në të cilën mori pjesë kryeministri Prof. Dr. Sali Berisha dhe drejtuesit e aksionerëve të TIA-s.
- Më 17 dhjetor 2008, TIA u nderua me marrjen e çmimit për leadershipin shqiptar, “për dhënien e një vizioni të ri të Tiranës si metropol”. Ky çmim u jepet kompanive të cilat tregojnë përgjegjësi të lartë sociale dhe kanë nxjerrë në pah standarde të shkëlqyera etike. TIA e ka përfutur këtë çmim për ndryshimin e imazhit të Shqipërisë në sytë e vizitorëve, biznesmenëve dhe turistëve.
- Gjatë vitit 2008 TIA ka qenë gjithashtu e përfshirë në promovimin e artit dhe mbështetjen e iniciativave sociale. Në këtë mënyrë TIA sponsorizoi një koncert me rastin e festivalit të xhazit në Shkodër dhe mbështeti një paradë mode. Për më tepër, punonjësit e TIA-s mbollën pemë në ditën Botërore për Mjedisin duke treguar përgjegjësinë e aeroportit në operimin e tij për një impakt sa më të vogël të mundshëm mbi mjedisin. TIA gjithashtu ka financuar Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë, një ndeshje bamirësie futbolli midis Milanit dhe Tiranës duke mbledhur fonde për UNESCO-n dhe për të mbështetur punonjësit e saj që u prekën nga shpërthimi i Gërdecit, në rikonstruksionin e shtëpive të tyre.


Zhvillimi i trafikut ajror

2008 ka qenë një vit i suksesshëm për sa i përket zhvillimeve të trafikut ajror për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. TIA shënoi rritje dyshifrore në numrin e pasagjerëve të shërbyer. Lëvizjet e trafikut ajror (ATM-të) shënuan një rritje me 5% dhe sasia e mallrave të përpunuar shënoi gjithashtu një rritje dyshifrore.

Statistika:

Statistika	Viti		Ndryshimi (%)
	2008	2007	
Pasagjerë	1,266,930	1,107,325	14,53
ATM-të	19,188	18,264	5,06
Mallra të përpunuar (tonë)	1,986	1,695	5,06

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ishte mjaft konkurrues gjatë vitit 2008, duke ofruar zgjedhje të larmishme fluturimesh, sidomos për në Greqi. Një treg i tillë parashtron mundësi të mira për zhvillim. Tregu i Greqisë është një ndër më të rëndësishmit duke patur parasysh që një numër i madh shqiptarësh jetojnë dhe punojnë atje. Aegean Airlines rriti frekuencën e udhëtimeve për/nga Athina



në gjashtë herë në javë. Sky Express, një tjetër linjë ajrore greke, filloi ofrimin e shërbimit nga fundi i vitit 2008 për në Heraklion.

Ndërkohë tregu italian mbetet një nga pikat kyçe për rritjen e shifrave të trafikut ajror. Belleair ofron një varietet të gjerë destinacionesh për në Itali me pika strategjike ndërlidhjeje me frekuencë të lartë. Duke nisur nga prilli 2008, Belleair ka filluar shërbimin për në Prishtinë/Kosovë.

Destinacion veror me fluturime direkte nga TIA mbetet Turqia me fluturim direkt nga TIA për në Antalia dhe Bodrum. Gjithashtu Sharm El Sheikh është një tjetër destinacion interesant i shërbyer nga TIA. Këtë vit për të parën herë agjencitë turistike ofruan Izraelin si një tjetër mundësi për pushimet verore duke mundësuar fluturime për një periudhë prej gjashtë javësh. Kjo ndodhi pasi qeveritë e të dy vendeve liberalizuan vizat mes Shqipërisë dhe Izraelit.

Në total 13 linja ajrore ofrojnë shërbimin e tyre pothuajse të përhershëm me 32 destinacione nga/për në TIA.

Lëvizjet e trafikut ajror (ATM-të) patën një rritje prej 5.06% gjatë vitit 2008 krahasuar me vitin 2007. Rritja në lëvizjen e trafikut ajror vjen kryesisht si rrjedhojë e Belleair, rritjes së frekuencave të udhëtimit nga Turkish Airlines dhe Adria Airways, si dhe fillimi i operimit të linjave Aegean Airlines and Sky Express.

Zhvillimi i Aeroportit

Në vitin 2008 zhvillimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës vazhdoi sipas projekteve të menaxhmit dhe në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Koncesionit me fillimin e zbatimit të Fazës B të projektit, duke filluar kështu zbatimin e punimeve për terminalin e ri të pasagjerëve të Fazës B.

Financimi i një projekti të tillë për zgjerim u përfundua në mars të vitit 2008 duke firmosur amendimin për rifillimin e marrëveshjeve të financimit me huadhënësit ekzistues nën huadhënësin kryesor EBRD. Bankat treguan përkushtimin e tyre ndaj këtij projekti duke dhënë një hua prej 22 milionë EUR për zbatimin e projektit të TIA-s.

Ceremonia e datës 25 korrik të vitit 2008 shënoi zyrtarisht fillimin e punimeve të Fazës B të Terminalit.


Zhvillime të tjera të aeroportit në 2008 përfshijnë:


- Si rrjedhojë e shpërthimit të Gërdecit, TIA pati dëmtime në terminalin e pasagjerëve, në terminalin e përpunimit të mallrave, dhe në godinën e administratës. Këto dëmtime u analizuan, u riparuan dhe u raportuan pranë kompanisë së sigurimeve përkatëse.
- Në nëntor të vitit 2008 TIA filloi punimet për rinovimin e Stacionit të Zjarrëfikseve dhe zonës së pajisjeve ajrore.
- Në fund të 2008, TIA filloi procedurat për një tjetër prokurim publik për zgjerimin e pistës.

Departamenti i Marketingut dhe Pronës

Departamenti i Marketingut dhe Pronës ka qenë i fokusuar në maksimizimin e të ardhurave gjatë vitit 2008. si rezultat, të gjitha aktivitetet tregtare kanë qenë në përputhje me objektivat e buxhetit.

Gjatë muajve të fundit të vitit 2008, departamenti i tregtisë dhe pronës është përfshirë në konceptin tregtar për zgjerimin e terminalit të ri të pasagjerëve për një inaugurim të suksesshëm dhe të shpejtë të punimeve të Fazës B, si dhe për realizimin e strukturave komerciale në bashkëpunim të ngushtë me qiramarrësit dhe konçesionarët.





Paralel me konceptin e dyqaneve për Fazën B, në terminal kanë filluar projektet për një pikë të re kambizmi dhe për një degë të re të një banke tjetër. TIA gjithashtu ka parashikuar zyra të tjera dhe sportele për biletat, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e linjave ajrore apo të agjensive të udhëtimit.

Burimet Njerëzore

Përveç rekrutimit të stafit sezonal, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka punësuar dhe dyzetë punonjës të rinj.

Gjatë vitit 2008 TIA ka përmbushur me sukses të gjitha trajnimet në lidhje me liçensimet për të qenë në lartësinë e standardeve operative të kërkuara. 3.8 ka qenë numri i ditëve të trajnimit për çdo punonjës gjatë vitit, ndërkohë që 88% e punonjësve të TIA-s janë trajnuar gjatë vitit.


Shëndeti, Cilësia dhe Siguria e Mjedisit


Në përputhje me politikat e shëndetit, cilësisë dhe sigurisë së mjedisit, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ofron shërbime me standarde të larta sigurie dhe komforti që synojnë kënaqësinë e klientëve. TIA është zotuar të operojë duke patur impakte minimale mbi mjedisin dhe komunitetin përreth, si dhe të krijojë një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurtë për punonjësit e saj.

Në këtë kornizë po numërojmë disa nga aktivitetet e ndërmarra nga TIA gjatë vitit 2008:

- Zbatimi efektiv i sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe mjedisit, duke siguruar mirëmbajtur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit në Aeroport, në përputhje me standardet e mjedisit dhe standardet mbi sigurinë dhe shëndetin në punë. Në këtë kontekst po bëhen auditime dhe inspektime të brendshme të cilësisë dhe mjedisit, për të korrigjuar apo parandaluar problemet e mundshme.
- Të vazhdueshme janë monitorimet për kontrollin e arritjes së objektivave në përputhje me Marrëveshjen e Koncesionit, politikat e cilësisë dhe mjedisit, si dhe Politikat e Sigurisë dhe Shëndetit.
- Për vitin e dytë rradhazi TIA ka ndërmarrë një sondazh mbi Kënaqësinë e Konsumatorëve, ku konsumatorët e cilësonin shërbimin e ofruar nga TIA si “shumë të mirë apo të shkëlqyer”.
- Aksione të vazhdueshme janë ndërmarrë për periudhën 2005 – 2010, për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë si dhe për Planin e Punëve Sociale, i cili u përditësua dhe u detajua me rastin e punimeve të zgjerimit të terminalit në Fazën B, duke vendosur veprime dhe qëllime specifike duke përfshirë dhe sa vijon:
 - Rishikimi i manualeve dhe procedurave
 - Cilësia e ajrit dhe kontrolli i konsumit të lëndëve djegëse
 - Cilësia e ujit dhe kontrolli i konsumit të ujit
 - Përmirësimi i sistemeve të drenazhit
 - Monitorimi i zhurmave dhe përdorimi i matësve të zhurmës
 - Reduktimi dhe mënyra e përdorimit të mbeturinave
 - Pajisja e stafit me mjete mbrojtëse personale
 - Trajnim dhe ndërgjegjësim

Për sa i përket zgjerimit të Fazës B, TIA ka detyruar nënkontraktorët të ndjekin të njëjtat masa mbrojtëse si dhe ajo vetë. Kështu që Programi i Monitorimit të Ndërtimeve për mbrojtjen e Mjedisit, pasi u revizionua dhe azhornua në vitin 2008 u firmos nga TIA dhe kompanitë e ndërtimit të përfshira në zgjerimin e Fazës B të aeroportit. Inspektime dhe observime në terren të ndërmarra në zonat ku





ndërtohet tregojnë se punimet e ndërtimit po zbatohen në përputhje me kërkesat mbi shëndetin dhe sigurinë e mjedisit.

Në vjeshtë të vitit 2008 u publikua Buletini i tretë Mjedisor dhe Social i cili informon publikun mbi veprimet e ndërmarra nga TIA për sigurimin e zhvillimit të aeroportit nëpërmjet një mënyre e cila garanton se standardet e cilësisë, shëndetit, sigurisë së shëndetit do të respektohen plotësisht.

Me pak fjalë, TIA ka dhënë prova se veprimet e ndërmarra nga ajo, janë në përputhje të plotë me standardet dhe kërkesat e rregullat, dhe nuk kanë patur as efekte negative mbi shëndetin e njerëzve dhe as impakte negative mbi mjedisin.

